

PËRGJEGJSHMËRIA E INSTITUCIONEVE QEVERISËSE TË KOSOVËS NË DREJTIM TË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT: AKTUALITETI DHE E ARDHMJA

*** Gentian ZYBERI¹**

Abstrakt:

Ky artikull fokusohet në çështjen e përgjegjshmërisë së institucioneve qeverisëse në Kosovë duke analizuar mandatet dhe mundësitë për përmirësim të organeve të besuara me mbikqyrjen dhe kontrollin e tyre në drejtim të respektimit dhe të krijimit të kushteve për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut në vend. Për këtë qëllim, përgjegjësia do të kuptohet si shkalla në të cilën një institucion dhe nëpunësit e tij janë përgjegjës për veprimet apo mosveprimet e tyre. Përgjegjshmëria është një element kyç i qeverisjes së mirë, së bashku me transparencën në marrjen e vendimeve dhe me forcimin e shtetit ligjor. Disa prej elementëve të nevojshëm për të krijuar institucione të përgjegjshme përfshijnë praninë e mekanizmave të pavarur tek të cilat viktimat mund të drejtohen me shqetësimet e tyre apo ku ato mund të ngrenë padi; mundësi ankimi ligjore e jo-ligjore; monitorim i jashtëm dhe mbikqyrje; si dhe këqyrje të kujdesshme nga media dhe organizatat joqeveritare.

Artikulli do të dalë me disa propozime konkrete për përmirësimin e strukturës dhe funksioneve të organeve përgjegjëse për shqyrtimin e abuzimit të mundshëm të të drejtave të njeriut nga institucionet qeverisëse në Kosovë. Për këtë qëllim, propozimet e paraqitura bazohen në strukturën e paraqitur në planin e Ahtisaarit, por që marrin parasysh edhe mundësi të tjera të zgjidhjes së statusit të Kosovës duke përfshirë edhe mundësinë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga ana e qeverisë dhe parlamentit të Kosovës.

Fjalët kyç: *Përgjegjshmëri individuale dhe institucionale, mundësi ankimuese gjyqësore dhe administrative, respektim i të drejtave të njeriut.*

* Gentian Zyberi, LL.M, Kandidat për Doktoraturë në të Drejtë Ndërkombëtare pranë Universitetit të Utrecht-it, Hollandë. Mendimet e shprehura këtu janë të autorit.

1. Hyrje

Pas një operacioni ushtarak që zgjati 78 ditë, nga 24 marsi deri me 11 qershor 1999, Kosova u çlirua nga forcat agresore serbe dhe shqiptarët e Kosovës, të dëbuar me dhunë, më në fund mundën të kthehen në vendin e tyre. Kosova, një vend që kishte njohur dy regjime paralele, atë të imponuar serb, si dhe strukturat paralele shtetërore të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) që pas heqjes së autonomisë nga regjimi i Millosheviçit në 1989, kishte përpara shumë sfida. Mes tyre ishte edhe krijimi i strukturave qeverisëse të cilat në ndryshim nga regjimi brutal shtetëror serb do të duhet të respektonin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Misioni i Kombeve të bashkuara në Kosovë (UNMIK), themeluar në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (KS) në 1999, mori në dorë drejtimin e Kosovës. Në kushtet e një vakuumi total institucionesh, strukturash, e logjistike, çdo gjë duhej ndërtuar nga themelet. Ndërsa përmbushja e nevojave elementare për ujë, drita, dhe shërbime elementare për qytetarët, ishte ndoshta më e thjeshtë për t'u arritur, krijimi i strukturave shtetërore si gjykatat, policia, strukturat e pushtetit qendror dhe lokal, si dhe krijimi i kushteve për kthimin e refugjatëve, kryesisht serbë, të larguar nga Kosova pas largimit të forcave ushtarake serbe, afërmendsh që do të kërkonin më shumë kohë dhe përpjekje. Gëzimi i të drejtave të njeriut është rezultatja e mirëfunksionimit të shtetit, ku një rol kyç luajnë parimet e mirëqeverisjes dhe përgjegjshmërisë së institucioneve ndaj qytetarëve. Ky element i fundit, gjegjësisht përgjegjshmëria e institucioneve vis-à-vis qytetarëve, përbën edhe subjektin e këtij artikulli.

Faktet e mësipërme, ndonëse të mirënjohura, ndihmojnë për të vënë në perspektivë situatën që mbizotëronte në Kosovë në momentin e krijimit dhe të vendosjes së UNMIK-ut. Duhet shtuar këtu se komuniteti ndërkombëtar, gjegjësisht Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), nuk kishte shumë eksperiencë me misione të tilla të një natyre të përzier administruese dhe shtetformuese njëkohësisht, ndërsa ajo ka mbikëqyrur procesin e dekolonizimit në vitet '60 e '70 të shekullit XX-të. Megjithatë, siç dihet mbikëqyrja dhe ndërtimi i një diçkaje nga themelet janë dy gjëra të ndryshme. Kudo ngritja dhe forcimi i institucioneve shtetërore demokratike është një proces relativisht i gjatë që kërkon kohë, përpjekje, vendosmëri, përkushtim dhe strategji të menduara mirë. Në rastin e Kosovës, kjo strategji duhej menduar për periudhën gjatë dhe pas-UNMIK. Me sa duket tek ky

element i fundit qëndronte edhe 'thembra e Akilit' e UNMIK-ut, si një mision i menduar me një afat të përkohshëm e gjithsesi të menduar si të shkurtër, deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës. Gjithsesi, ky artikull nuk synon të bëjë një vlerësim të punës së UNMIK-ut, as dhe arsyet që mund të kenë ndikuar negativisht në përpjekjet e këtij të fundit për të përmbushur misionin e besuar, pasi këto mund të jenë subjekt i reflektimeve në një kohë të mëvonshme. Ajo çfarë synohet të arrihet në këtë punim modest është shqyrtimi i çështjes së përgjegjësisë së aktorëve mbajtës të pushtetit në Kosovë në përgjithësi, dhe të atyre të huaj në veçanti, në funksion të respektimit të plotë të të drejtave të njeriut të qytetarëve të Kosovës.

Meqenëse strukturat e tanishme do të ndryshojnë me adoptimin (potencial) të planit të z. Ahtisaari, i cili deri më tani është i vetmi propozim në tavolinë që ka mbështetjen e shumicës së opinionit dhe komunitetit ndërkombëtar, vetëkuptohet që referencë do t'i bëhet në vijim disa prej institucioneve që janë parashikuar që të veprojnë në Kosovë provizorisht pas mbarimit të misionit të UNMIK-ut deri në kalimin e plotë të pushtetit në duart e qeverisë së Kosovës. Strukturat kryesore që do të krijohen sipas planit të Ahtisaarit janë Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ose Përfaqësuesi Special i Bashkimit Europian (PSBE, Misioni i Politikës Europiane për Siguri dhe Mbrojtje (MPESM) si dhe Prania Ushtarake Ndërkombëtare (PUN).² Fokusi i këtij artikulli do të përqendrohet më shumë në strukturat e drejtësisë që mendohet të krijohen në kuadrin e këtij plani si një element me peshë të madhe në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe funksionet e tyre në këtë drejtim. Janë këto organe shtetërore që luajnë rolin kryesor në vënien në jetë të këtij elementi të domosdoshëm në çdo sistem demokratik, përkatësisht atë të përgjegjshmërisë së strukturave shtetërore në funksion të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Për këtë qëllim, përgjegjësia do të kuptohet si shkalla në të cilën një institucion dhe nëpunësit e tij janë përgjegjës për veprimet apo mosveprimet e tyre. Përgjegjshmëria është një element kyç i qeverisjes së mirë, së bashku me transparencën në marrjen e vendimeve dhe forcimin e shtetit ligjor. Disa prej elementëve të nevojshëm për të krijuar institucione të përgjegjshme përfshijnë praninë e mekanizmave të pavarur tek të cilat

² Shih Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, versioni shqip në <http://www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html>.

viktimat mund të ngrenë padi; mundësi ankimi gjyqësor apo administrativ; monitorim i jashtëm dhe mbikqyrje; si dhe këqyrje të kujdesshme nga media dhe organizatat joqeveritare.³ Siç është vënë në dukje edhe nga paraardhësi i Këshillit të të Drejtave të Njeriut (në anglisht United Nations Human Rights Council, shkurt HRCn), Komisioni i të Drejtave të Njeriut (në anglisht United Nations Human Rights Commission, shkurt HRCs) përgjegjshmëria e institucioneve është një element kyç për gëzimin e të drejtave të njeriut.⁴

2. Zgjidhja e Statusit të Kosovës dhe Influenca e saj në Situatën në Kosovë

Kosova është në fazën finale të përcaktimit të statusit të saj. Kjo sipas zhvillimeve të fundit mund të vijë sipas planit të Ahtisaarit ose sipas ndonjë formule tjetër të arritur nga vetë palët, megjithëse kjo mundësi e fundit është larg çdo realiteti. Duhet theksuar që, ashtu si në rastin e Rambujesë, ishte pala serbe ajo që nuk e pranoi një zgjidhje të formuluar nga faktori ndërkombëtar, në këtë rast i sjellë nga ekipi i të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara pas 13 muaj bisedimesh.⁵ Kjo demonstroi edhe një herë që politika zyrtare serbe nuk ka ndryshuar kurs qysh nga kohët kur vendi drejtohej nga Millosheviçi.

Pavarësisht prej zhvillimeve në fushën e diplomacisë ndërkombëtare dhe komenteve që fluturojnë nga të katër anët, vetëkuptohet që Kosova duhet të ndjekë rrugën e vet drejt përgatitjes institucionale për pavarësi në një të ardhme të afërt. Është për këtë që institucione e mekanizma duhet të krijohen të cilat mundësojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim etnie e statusi shoqëror. Mirëqeverisja, përgjegjshmëria e institucioneve dhe gëzimi i të drejtave të njeriut janë në raport të drejtë me njëra-tjetrën. Më duhet të them me keqardhje që edhe pse nga 1999 UNMIK-u ka funksionuar efektivisht si qeveria e Kosovës dhe përgjatë këtyre tetë vjetëve nuk ka arritur që ta shndërrojë veten në një model të praktikave të mirëqeverisjes. Përveç shkeljeve të të drejtave të njeriut që nuk janë hetuar të tjera skandale financiare kanë përcjellë këtë qeverisje gjatë këtyre viteve.

³ Human Rights Watch, *Better Late Than Never: Enhancing the Accountability of International Institutions in Kosovo*, No. 2, June 2007, fq. 8.

⁴ Shih HRCs, Rezoluta 2000/64, E/CN.4/2003/102, titulluar 'Roli i Qeverisjes së Mirë në Promovimin e të Drejtave të Njeriut'.

⁵ Për propozimin vizitoni: <http://www.unosek.org/unosek/index.html>.

Pavarësisht vullnetit të mirë dhe njohurive të specialistëve ndërkombëtarë, një pushtet i mbuluar me imunitete nuk mund të transformohet në një pushtet të drejtë. Sic thuhet pushteti korrupton dhe pushteti absolut korrupton në mënyrë absolute. Ashtu si të gjitha burokracitë, një mision i tillë pasi krijohet e vihet në lëvizje, ka tendencë për të zgjatur ekzistencën e tij (misioni, mashk.). Kjo e ashtuquajtur ‘rezistencë e administratës’ nuk është specifike e UNMIK-ut, por e administratave kombëtare e ndërkombëtare në përgjithësi. Një proces i tillë mund të krahasohet më një proces zvarritjeje dhe mosvullneti për kalimin e pushteteve atyre që e marrin mandatin dhe kontrollohen nga vota e popullit. Jo më kot qeverisja e çdo vendi demokratik ka nevojë për legjitimim nga populli të cilin ajo qeveris. Në këtë mënyrë populli bëhet pjesë e qeverisjes dhe e kontrollon atë nëpërmjet votës.

Mungesa e mekanizmave formale për të siguruar një përgjegjshmëri të administratës ndërkombëtare së bashku me padurimin e popullit të Kosovës për një përcaktim të statusit dhe bashkëlidhur me të edhe të të ardhmes së tyre ka influencuar në një perceptim të UNMIK-ut si një lloj ‘pushtuesi i ri’. Qëndrimi refraktar e i vonuar i këtij të fundit në disa raste, duke kulmuar me atë të incidentit të 10 shkurtit, ku 2 demonstrues vdiqën gjatë protestës së organizuar nga organizata Vetëvendosja, vetëm sa ia ka ulur kuotat e aprovimit këtij misioni. Pra, çështja ka ardhur në domosdoshmërinë për një ndryshim të status quo-së dhe një drite në fund të tunelit për zgjidhjen e statusit dhe formës së re të qeverisjes së Kosovës. Një qeverisje e tillë duhet futur qysh prej fillimit në shinat e mbikëqyrjes dhe kontrollit të dyfishtë: kombëtar e ndërkombëtar.

3. Gjendja e Tanishme e Mbikëqyrjes së Respektimit të të Drejtave të Njeriut në Kosovë

Që nga instalimi i UNMIK-ut e deri më tani, ka pasur disa struktura që kanë pasur për detyrë që të monitorojnë dhe vlerësojnë e bëjnë rekomandime ndaj organeve qeverisëse të Kosovës, si ato kombëtare ashtu edhe ndaj atyre ndërkombëtare, për një respektim sa më të mirë të të drejtave të njeriut në Kosovë. Këtu më poshtë do të jetë një ekspozitë e shkurtër e këtyre mekanizmave parë me një vështrim kritik në lidhje me funksionin dhe rolin e tyre në rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve qeverisëse në Kosovë përsa i përket këtyre të drejtave.

Po çfarë janë këto të drejta të cilave ne u referohemi sa herë? Cili është kuadri ligjor në lidhje me to që është i zbatueshëm në Kosovë? E pra, ja vlen të theksohet se kuadri ligjor i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë përfshin që nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e 1948-ës të gjitha marrëveshjet e rëndësishme ndërkombëtare si Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Kulturore dhe Sociale, Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Torturës, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, sa për të përmendur disa prej atyre më të rëndësishmeve.

Le të shohim se cilat janë mekanizmat e mbikëqyrjes, apo siç thuhet shpesh monitorimit të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovën e pasluftës. Këto mekanizma janë përkatësisht Avokati i Popullit (Ombudsmeni), Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Mbikëqyrës i të Drejtave të Njeriut, Komisioni i Ankesave të UNMIK-ut, Inspektorati i Policisë së Kosovës, që shqyrton ankesa vetëm në lidhje me Shërbimin Policor të Kosovës, jo policinë e UNMIK-ut, monitorimi i Këshillit të Europës, si dhe monitorimi i OSBE-së. E pra, me kaq organe mbikëqyrëse dhe monitorim nga OSBE-ja e Këshilli i Europës (KE), do të ishte afërmendsh që individët do të kishin më shumë se një forum ku të sillnin ankesat e tyre dhe të gjenin të drejtën e tyre.

Këtu më poshtë do të trajtojmë në mënyrë krejt të shkurtër funksionet dhe juridiksionin e disa prej organeve të sipërpërmendura.

A) Avokati i Popullit (AP ose Ombudsman)

Ky është organi kryesor për marrjen e ankesave nga individët, ankesa këto të lidhura me abuzimin e pushtetit nga institucionet e Kosovës krijuar në vitin 2000. Deri në shkurt 2006 AP kishte të drejtë të shqyrtonte shkeljet e të drejtave të njeriut që rridhnin prej veprimeve të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, duke përfshirë UNMIK-un, policinë ndërkombëtare dhe KFOR-in.⁶ Gjithsesi, në shkurt 2006 mandati i AP është kufizuar në shkeljet e bëra nga institucionet vendase. Tashmë mandati i AP është kufizuar në sjelljen e atyre mekanizmave të hapur ndaj publikut për shqyrtimin e shpejtë të

⁶ Shih për këtë rregulloren e UNMIK-ut 2000/38, "Mbi Krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë".

veprimeve që përbëjnë një abuzim të autoritetit nga organet qeverisëse të Kosovës dhe të bëjë rekomandime për riparimin e tyre.

Gjatë kohës kur Ombudsmani në Kosovë ishte ish-gjykatësi i Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut (GjEDNj), z. Marek Nowicki, ky institucion i shtriu zyrat e tij përgjatë Kosovës. Gjithashtu kishte edhe 'ditë të hapura' kur AP udhëtonte nëpër Kosovë për të rritur njohurinë rreth këtij institucioni por edhe për të takuar drejtpërdrejt persona të prekur nga abuzime të mundshme. Ankesat më të zakonshme të marra lidheshin me të drejtat e pronësisë si dhe kushtet e zhvendosjes. Në kushtet e zhvendosjes masive të popullsisë shqiptare së Kosovës gjatë luftës, të largimit të një pjese të madhe të popullsisë serbe pas luftës, si dhe zhvillime të tjera në terren pas lufte janë disa prej arsyeve se pse këto ankesa janë ato më kryesoret. Përveç këtyre ankesave të mësipërme, ankesa të tjera të zakonshme ishin edhe ato për arrestime dhe kërkimit për armë.

Heqja e mandatit të AP për të hetuar abuzime të të drejtave të njeriut të kryera nga institucionet ndërkombëtare është një hap prapa për respektimin e të drejtave të njeriut, përgjegjshmërisë së institucioneve ndaj të qeverisurve, si dhe forcimit të sundimit të shtetit ligjor në Kosovë. Në të kundërt, ky institucion duhet të shërbente si një institucion i pavarur mbikëqyrjeje i të gjitha institucioneve në Kosovë, vendase dhe ndërkombëtare.

B) Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut

Ky organ i krijuar rishtas, ka detyrë që të ekzaminojë ankesat individuale apo kolektive mbi shkelje të të drejtave të njeriut që rezultojnë nga veprime të UNMIK-ut.⁷ Pra, ky është një funksion i hequr prej Ombudsmanit që i ka kaluar një organi tjetër. Përveç sinjalit të gabuar që dërgon një veprim i tillë dhe trajtimi i ndryshëm i personave të angazhuar në funksione qeverisëse në Kosovë, krijimi i këtij organi duket sikur shkel parimin e barazisë para ligjit. Ndonëse tre personat e caktuar për një afat njëvjeçar janë mjaft të njohur, përkatësisht, z. Nowicki, ish-Ombudsmani i Kosovës, z. Paul Lemmens, profesor belg në Institutin e të Drejtave të Njeriut në Universitetin e Leuvenit,⁸ si dhe

⁷ Për funksionin e këtij Paneli vizitoni version shqip në http://www.unmikonline.org/human_rights/alb/index.htm kurse për atë në anglisht http://www.unmikonline.org/human_rights/index.htm (hera e fundit e vizitës 6 gusht 2007).

⁸ Për një biografi të z. Lemmens në anglisht vizitoni <http://www.law.kuleuven.be/humanrights/lemmens.html>.

gjykatësi francez z. Michele Picard. Së bashku këta tre persona kanë të gjithë ekspertizën dhe autoritetin e duhur për të bërë një punë të mirë në këtë drejtim.

Gjithsesi, kjo nuk duket se do të mjaftojë pasi, megjithëse i parashikuar për të filluar punë nga mesi i vitit 2006 për të mbushur boshllëkun e krijuar në punën e Ombudmanit, ky Panel nuk ka filluar nga puna akoma për mungesë stafi, zyrash dhe buxheti. Përveç mungesave logjistike, mandati i këtij Paneli është i tipit këshillimor, ashtu siç e sugjeron edhe emri, ku rekomandimet në qoftë se ka pas shqyrtimit të ankesës i jepen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Ndërsa ky Panel është krijuar nga UNMIK-u, anëtarët e tij janë caktuar nga UNMIK-u, dhe procedurat e veprimtarisë së tyre mund të ndryshohen nga UNMIK-u, atëherë pavarësia dhe efikasiteti i një organi të tillë mund të kompromentohen. Është për këto arsye që edhe Komiteti i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara, organi monitorues i KNDCP, ka shprehur shqetësimin që Paneli Këshillimor i të Drejtave të Njeriut i krijuar nga UNMIK për të marrë dhe shqyrtuar ankesa kundër UNMIK-ut i mungon pavarësia dhe autoriteti i nevojshëm.⁹ Mandati i kufizuar, varësia e plotë nga UNMIK-u, stafi dhe buxheti i kufizuar, si dhe me shumë gjasë mungesa e pranisë së përhershme të tre panelistëve në vend, janë faktorë që militojnë kundër një pune efektive të këtij Paneli në shqyrtimin e abuzimeve nga UNMIK-u.

C) Komiteti Mbikëqyrës i të Drejtave të Njeriut

Në morinë e institucioneve të krijuara nga UNMIK-u për të adresuar çështjen e të drejtave të njeriut një vend të rëndësishëm zë edhe Komiteti Mbikëqyrës për të Drejtat e Njeriut. Ky komitet, i njohur me akronimin HROC, (nga anglishtja shkurtim i Human Rights Oversight Committee), u krijua në 2002 për t'i dhënë rekomandime Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PS-SP) për çështje të të drejtave të njeriut, duke përfshirë përshtatshmërinë e rregulloreve me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe raste individuale të profilit të lartë, dhe për t'ju përgjigjur kritikave të

⁹ Për një listë të plotë dokumenteve në lidhje me shqyrtimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në sesionin e 87-të të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara vizitoni <http://www.ohchr.org/english/bodies/hrc/hrcs87.htm>. Shih gjithashtu Vështrimet Përfundimtare, CCPR/C/UNK/CO/1, 14 gusht 2006. Është për t'u çuditur që ashtu siç përshkruhet në hyrjen e dokumentit të fundit, pikës 3, Serbia është dashur të lehtësojë dialogun mes këtij Komiteti dhe UNMIK-ut në lidhje me zbatimin e KNDCP në Kosovë, ndërsa të dy këto organe janë pjesë e OKB-së dhe mund të komunikojnë drejtpërdrejt.

drejtuar ndaj UNMIK-ut prej organizatave të tjera. Anëtarësia e këtij Komiteti përfshin zëvendësin kryesor të PS-SP-së, drejtuesin e OSBE-së dhe misioneve të BE-së, këshilltarin ligjor të UNMIK-ut, drejtorin e Zyrës së Kthimeve dhe Komuniteteve të UNMIK-ut, drejtuesin e zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, drejtuesin e Zyrës së UNMIK-ut për Çështjet Gjinore, drejtuesin e Departamentit të OSBE-së për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, si dhe zëvendës-komandantin e KFOR-it.

Siç shihet nga përbërja e këtij komiteti, pesha dhe roli i tij në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë nga të gjitha institucionet qeverisëse duhet të ishte shumë i madh. Në të vërtetë edhe pse ky organ akoma ekziston formalisht nuk është mbledhur më qysh në vitin 2004. Ndërsa është e kuptueshme vështirësia e kombinimit të agjendave të punës së shumë personave në poste kyçe drejtuese, është vështirë të kuptohet se pse ky organ pushoi krejtësisht së funksionuari!

D) Komisioni i Ankesave të UNMIK-ut

Një tjetër organ i menduar për t'u marrë me padi prej palëve të treta për humbje të pronësisë, dëme dhe dëmtime personale, sëmundje apo vdekje që vjen prej apo mund t'i atribuohet KFOR-it, UNMIK-ut, apo personelit të tyre përkatës dhe që nuk vijnë nga 'nevoja operationale' të pranisë ndërkombëtare, duhej të krijohet në vitin 2000.¹⁰ Megjithatë nuk është e sigurt nëse ky organ është krijuar ndonjëherë për të përmbushur funksionet e përshkruara më sipër. Duket se ky Komision e ka ngushtuar mandatin e vet në shqyrtimin e përgjegjësisë që rrjedh prej konflikteve kontraktuale që kanë UNMIK-un si njëri nga palët. Ndërsa ky organ duhet të kishte qenë një mekanizëm për t'u krijuar mundësinë qytetarëve të Kosovës që të sillnin para tij paditë e tyre civile ndaj UNMIK-ut duket se ai është një Komision që zgjidh paditë civile mes UNMIK-ut e kontraktorëve të tij.

E) Disa Vërejtje

¹⁰ Shih Rregulloren Nr. 2000/47 të UNMIK-ut e 18 Gushtit 2000 titulluar "Mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe Personelit të tyre në Kosovë", seksioni 7, Përgjegjësia për Palët e Treta.

Siç shihet nga ky vështrim i shkurtër mbi disa prej organeve që duhej të shërbenin për krijimin e një fryme përgjegjshmërie mbi organet vendase të qeverisjes, por edhe mbi institucionet ndërkombëtare si UNMIK-u dhe KFOR-i, ky funksion nuk është arritur. Ndonëse arsyet mund të jenë të shumta, rezultati është i njëjtë: që gjendja e krijuar në Kosovë i ka alienuar në një masë të konsiderueshme institucionet ndërkombëtare nga qytetarët. Kujdesi i munguar në plotësimin e këtij boshllëku të mungesës së përgjegjësive e përgjegjshmërisë së institucioneve ndërkombëtare, edhe kur ka pasur mjaftueshëm rekomandime nga aktorë të ndryshëm, si dhe mundësi për ta përmirësuar gjendjen, flet për një mosinteresim në rastin më të mirë dhe një mungesë totale përgjegjësie në rastin më të keq. Vështirësia e viktimave të abuzimeve nga UNMIK-u apo KFOR-i për tu ankimuar, si në organet vendore ashtu edhe në ato të huaja, apo dhe ndërkombëtare, del qartë nga disa raste të nisura para GjEDNj,¹¹ si dhe një rast të paraqitur para Komitetit për të Drejtat e Njeriut të KNDCP.¹² Këto vështirësi lidhen përgjithësisht me mungesën e transparencës së procedurave të ankimit, mungesën e njohurive dhe të mjeteve financiare për të ndjekur rastin në organe të larta ndërkombëtare apo të huaja e kështu me radhë. Megjithatë, ashtu si vërtetohet nga rastet e përmendura më sipër të cilat u përkasin viteve të fundit ka një rritje të njohurive dhe kapacitetit ligjor për ndjekjen e këtyre rasteve.

4. Mbikëqyrja e Respektimit të të Drejtave të Njeriut në të Ardhmen

Kosova ndodhet akoma nën udhëheqjen e UNMIK-ut dhe akoma nuk është e qartë se si do të procedohet më tej dhe se kur saktësisht një status i ri dhe një strukturë organesh qeverisëse do të zënë vendin e misionit të OKB-së. Plani prej 58 faqesh i përgatitur nga i Dërguari Special Martti Ahtisaari duket sikur është vënë nën menjanë për momentin ndërsa qeveria serbe e mbështetur nga ajo ruse do të kërkojnë më tej lëshime për çdo rast, ndërsa qëllimi i tyre kryesor është moslejimi i krijimit të shtetit të pavarur të Kosovës dhe shtrëngimi i Kosovës që të rrijë së bashku me Serbinë në një formë apo tjetër . Në këto kushte, ndonëse në vija të trasha ky punim i merr në konsideratë propozimet e Ahtisaarit

¹¹ Shih përkatësisht *Behrami v. Francë* (Rasti Nr. 71412/01) dhe *Saramati v. Francë, Norvegji dhe Gjermani* (Rasti Nr. 78166/01) përpara Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

¹² Shih Komunikimi 1374/2005 (CCPR/C/87/D/1374/2005), *Azem Kurbogaj dhe Xhevdet Kurbogaj v. Spanjë*, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 14 korrik 2006.

në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut ai përfshin edhe disa rekomandime konkrete, të cilat mund të merren parasysh nga qeveria e Kosovës, sidomos në variantin e shpalljes së njëanshme të pavarësisë.

Ndërsa plani Ahtisaari bazohet në një tranzicion drejt pavarësisë, ose siç njihet ndryshe pavarësi e kushtëzuar apo me etapa, duket se kundërshtimet e qeverisë serbe, mbështetur nga ajo ruse, ndaj këtij plani e kanë vënë në dyshim mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje mes dy palëve. Kjo gjë lë hapur një mundësi, atë të shpalljes së njëanshme të pavarësisë. Ndonëse i sulmuar si një hap i rrezikshëm për stabilitetin në Ballkan, duket se kjo është rruga e vetme që i është lënë hapur shqiptarëve të Kosovës, përveç mbetjes nën Serbinë. Duke folur në lidhje me këtë opsion z. Çeku paralajmëroi se mund ta shpallë atë në mënyrë të njëanshme me datë 28 Nëntor. Megjithatë, kjo deklaratë u sfumua shpejt kur u deklarua më pas se Kosova do të bëjë të gjitha përpjekjet për një zgjidhje në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar.

Ky seksion i artikullit mbështetet pjesërisht në planin e Ahtisaarit dhe pjesërisht në mundësinë e shpalljes së pavarësisë në mënyrë të njëanshme nga qeveria e parlamenti i Kosovës.

A) Avokati i Popullit

Ky organ duhet të ketë një rol kryesor në linjën e parë të mbrojtjes së qytetarëve prej abuzimit të pushtetit. Edhe nëse do të ketë institucione ndërkombëtare në Kosovë, si pjesë e një periudhe tranzicioni drejt pavarësisë këto duhet t'i nënshtrohen kontrollit të këtij institucioni ashtu sikur edhe ishte gjendja prej vitit 2000 deri në fillim të vitit 2006. Organet qeverisëse vendore dhe ndërkombëtare duhen që t'i japin këtij institucioni të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për të ekzaminuar të gjitha ankesat e paraqitura para këtij institucioni.

B) Gjykata Kushtetuese

Sipas planit të Ahtisaarit Gjykata Kushtetuese duhet të jetë organi më i lartë që do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e çdo ligji apo vendimi që do t'i referohet. Gjithashtu, reflektuar në këtë propozim është edhe kërkesa që kushtetuta duhet t'i mundësojë individëve, të drejtat e të cilëve janë shkelur nga një autoritet publik që të kenë mundësi

të paraqesin një ankesë-padi në Gjykatën Kushtetuese, pasi të kenë shteruar të gjitha mundësitë e tjera.¹³ Sipas këtij propozimi gjykata duhet të ndërtohet prej gjashtë gjykatësve vendas dhe tre gjykatësve ndërkombëtarë, ku gjykatësit vendas do të emërohen nga Presidenti me propozimin e Kuvendit të Kosovës, ndërsa emërimet ndërkombëtare do të bëhen nga Presidenti i GjEDNj në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar. Do të ishte me vend që dy prej gjykatësve vendas të vinin prej minoriteteve kryesore në Kosovë. Kjo, bashkë me faktorin ndërkombëtar duhet të krijojë besimin e duhur tek ky institucion, si një institucion në shërbim të të drejtave dhe interesave të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

C) Vëzhgimi Ndërkombëtar

Monitorimi ndërkombëtar në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut nga OSBE-ja dhe Këshilli i Europës si dhe Misioni i BE-së duhet të vazhdojë derisa edhe Kosova të bëhet pjesë integrale e Bashkimit Europian. Në lidhje me këtë të gjitha këto institucione duhet të mbajnë një prani në Kosovë, që duhet të jetë e angazhuar në ofrimin e ndihmës teknike dhe financiare ndaj organeve kosovare të qeverisjes, si dhe në monitorimin e respektimit nga kjo e fundit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Çfarëdo emri që mund të ketë prania ndërkombëtare e veshur me pushtet qeverisës në Kosovë, ajo duhet të jetë monitoruese dhe e monitoruar në aktivitetin e saj. Vetëm në këtë mënyrë kjo prani ndërkombëtare do të ketë besimin e qytetarëve të Kosovës. E integruar në këtë mënyrë, kjo prani ndërkombëtare do t'i shërbejë krijimit të një strukturë funksionale dhe efektive për përgjegjshmërinë e institucioneve qeverisëse, e cila do të rezultonte në respektim dhe gëzim në një shkallë më të lartë të lirive dhe të drejtave të njeriut.

5. Konkluzione dhe Rekomandime

Suksesi i qeverisjes në Kosovë varet nga aftësia e institucioneve qeverisëse, vendase e të huaja, që të ruajnë legjitimitetin dhe besueshmërinë në sytë e publikut. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet transparencës, përgjegjshmërisë institucionale, respektimit të parimit të sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Ndërsa shumë organe për të

¹³ Plani Ahtisaari, Aneksi 1, Artikulli 2.4

adresuar respektimin e këtyre të drejtave janë krijuar në Kosovë nën udhëheqjen e UNMIK-ut, duket se këto mekanizma ose nuk kanë funksionuar fare, si në rastin e Komitetit Mbikëqyrës të të Drejtave të Njeriut, ose qëllimi për të cilin u krijuan u modifikua më pas, si në rastin e Komisionit të Ankesave të UNMIK-ut. Edhe në rastin e reformave ligjore në këtë drejtim, si në rastin e Ombudsmanit, një institucion i konsoliduar e me shtrirje të gjerë, heqja e mandatit për shqyrtimin e ankesave ndaj UNMIK-ut nuk e ka ndihmuar çështjen e të drejtave të njeriut, dhe vetë UNMIK-un për të fituar mendjet dhe zemrat e kosovarëve.

Ndërsa ka volume të tëra të analizave të përgatitura dhe rekomandimeve nga aktorë të ndryshëm në lidhje me mbylljen e hapësirës së përgjegjshmërisë në Kosovë, pak progres është bërë në këtë drejtim. Tranzicioni nga UNMIK-u drejt vetëqeverisjes krijon një mundësi për të krijuar më në fund mekanizma funksionalë dhe efektivë për monitorimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut nga organet qeverisëse. Mbikëqyrja e institucioneve të ardhshme të Kosovës në nivel kombëtar duhet bërë nëpërmjet mekanizmave të tillë si Avokati i Popullit (Ombudsmani) si dhe Gjykata Kushtetuese. Në nivel ndërkombëtar një forum i përshtatshëm për ankesat e qytetarëve të Kosovës është Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Nuk është më koha për eksperimente ndërkombëtare por për kalimin e të gjitha funksioneve qeverisëse qytetarëve të Kosovës ku organet ndërkombëtare si OSBE-ja dhe Këshilli i Europës të kenë funksione vëzhguese të respektimit të të drejtave të njeriut, ndërsa përgjegjësia për respektimin e këtyre të fundit si dhe krijimin e mundësive për gëzimin e këtyre të drejtave t'i kalohet organeve qeverisëse vendore. Vetëm kështu përgjegjësia do u kalojë atyre që nuk mund të fshihen dot pas privilegjeve e imuniteteve por janë përgjegjës para popullit të Kosovës nëpërmjet mekanizmit të votës si dhe organeve të pavarura të mbikëqyrjes e kontrollit.

BIBLIOGRAFI

Raporte

Pasqyrë mbi Sistemin e Gjyqësisë Penale në Kosovë 1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001,
Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës, OSBE

Raport për Gjendjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Kosovë në Vitin 2002, Këshilli
për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, Prishtinë, Janar 2003

Opinion on Human Rights in Kosovo: Possible Establishment of Review Mechanisms,
Venice Commission, CDL-AD (2004)033, Opinion No. 280/2004

Askund në agjendë: Dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas
marsit 2004, Human Rights Watch Vëll. 18, Nr. 4(D), Maj 2006

*Better Late Than Never: Enhancing the Accountability of International Institutions in
Kosovo*, Human Rights Watch, June 2007

Faqe Interneti:

Faqja Zyrtare e UNMIK-ut: <http://www.unmikonline.org>

Faqja e Ombudpersonit: <http://www.ombudspersonkosovo.org/?cid=1,1>

Faqja e Panelit Këshillimor për të Drejtat e Njeriut:
http://www.unmikonline.org/human_rights/index.htm

Faqja e Misionit të OSBE-së në Kosovë: <http://www.osce.org/kosovo/13215.html>

Faqja e Zyrës së të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Procesin e Statusit
të Ardhsëm z. Martti Ahtisaari: <http://www.unosek.org/unosek/index.html>

Konsiderimi i Raportit të UNMIK-ut nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut të KNDCP:

<http://www.ohchr.org/english/bodies/hrc/hracs87.htm>

Faqja e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë:

http://www.unhchr.ch/html/menu2/5/kosovo/kosovo_main.htm

Faqja e Opinionit të Komisionit të Venecias mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë:

http://www.venice.coe.int/site/dynamics/N_Opinion_ef.asp?L=E&OID=280